



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE

RELACION  
PËR  
PROJEKTLIGJIN  
“PËR BANKËN SHQIPTARE TË ZHVILLIMIT”

**I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN**

Projektligji “Për Bankën Shqiptare të Zhvillimit”, në vijim Banka e Zhvillimit (BZH), ka si qëllim themelimin dhe përcaktimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e një institucioni financiar zhvillimi, i ngjashëm me Bankat/Institucionet Kombëtare Promovuese (National Promotional Banks/Institutions) që funksionojnë në Bashkimin Evropian, me synim kryesor nxitjen e zhvillimit ekonomik dhe social të vendit, përmes lehtësimit të qasjes në financë të sektorëve të nënfinancuar të ekonomisë, kryesisht ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, përfshirë mikrondërmarrjet dhe *start-up*-et si edhe mbështetjes së projekteve zhvillimore që lidhen me përmirësimin dhe modernizimin e infrastrukturës fizike dhe digjitale, me fokus të veçantë tek investimet e gjelbra.

Bankat dhe Institucionet Financiare Promovuese në BE përkufizohen si entitete që kryejnë veprimtari financiare me një mandat të dhënë nga një shtet në nivel qendror, rajonal ose lokal, për të arritur synime zhvillimore apo promovuese<sup>1</sup>. Ato luajnë, ndër të tjera, edhe rolin e ndërmjetësve financiarë për Bankën Evropiane të Investimeve (BEI), duke kanalizuar linjat e kredive apo instrumente garancie të BEI në ekonomitë lokale. Disa prej këtyre linjave dhe instrumenteve janë të hapura edhe për vende të Ballkanit Perëndimor dhe gama e tyre zgjerohet edhe më tepër me avancimin në procesin e integritimit.

Arsyetimi kryesor ekonomik për ekzistencën e një institucioni të tillë bazohet në faktin se operimi nën potencial apo dështimet e tregut (market failures) mund të çojnë në mungesë financimi dhe investimesh që, si rezultat, sjellin një rritje më të ngadaltë sesa ajo që do të ishte ekonomikisht e

<sup>1</sup> Neni 2(3) i Rregullores (BE) 2015/1017 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, më 25 Qershor 2015, mbi Fondin Evropian për Investime Strategjike, Qendrën Këshilluese për Investime Evropiane dhe Portalin e Projekteve të Investimeve Evropiane, si dhe ndryshimin e Rregulloreve (BE) Nr. 1291/2013 dhe (BE) Nr. 1316/2013 — Fondi Evropian për Investime Strategjike.

dobishme apo e synuar. Këto institucione ndërhyjnë në ato segmente që mbeten të nënfinancuara apo të nënshërbyera, duke synuar një qasje plotësuese ndaj financimeve që ofrohen nga operatorët tregtarë financiarë. Veprimtaria e tyre ushtrohet në përputhje me legjislacionin për ndihmën shtetërore dhe pa shkaktuar ndikim të padrejtë në konkurrencë<sup>2</sup>.

Projektligji për krijimin e Bankës Shqiptare të Zhvillimit është hartuar në bashkëpunim me Cassa Depositi e Prestiti (CDP) të Italisë, një nga institucionet më të njohura dhe me përvojë në këtë fushë, që ka luajtur rol të rëndësishëm në zhvillimin e ekonomisë italiane. Bashkëpunimi bazohet në një memorandum mirëkuptimi, në bazë të cilit CDP ka ofruar ekspertizë të thelluar për konceptimin e Bankës Shqiptare të Zhvillimit dhe pritet gjithashtu të japë mbështetje teknike për fazat e mëtejshme të ngritjes dhe vënies në operim të institucionit përgjatë fillimit të aktivitetit të saj.

Projektligji parashikon se veprimtaria e Bankës së Zhvillimit do të fokusohet në fushat e treguara në vijim.

Objektivat kryesore të këtij institucioni, të cilat janë objektivat promovuese, janë hartuar në mënyrë që të krijojnë një ndikim të gjerë dhe të qëndrueshëm, siç vijon më poshtë:

### **1. Mbështetja e Sipërmarrjeve Shqiptare**

BZH synon të fuqizojë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NMV) dhe startup-et, duke ofruar financim dhe, sipas rastit mbështetje teknike, për të ndihmuar këto biznese të përmirësojnë produktivitetin, të rrisin konkurrueshmërinë dhe të zgjerojnë prezencën e tyre në tregjet ndërkombëtare.

### **2. Promovimi i Eksporteve**

Një nga objektivat e BZH, që gjendet edhe në një sërë institucionesh të ngjashme evropiane, është mbështetja e eksporteve shqiptare duke inkurajuar prodhimin dhe shërbimet që mund të konkurrojnë me sukses në tregjet jashtë vendit.

### **3. Mbështetja e projekteve me rëndësi për zhvillimin ekonomik,**

Në këtë kuadër, BZH do të veprojë kryesisht në rolin e ndërmjetësit financiar, duke kanalizuar fonde ose linja financimi nga institucionet financiare ndërkombëtare, ato evropiane apo partnerë të tjerë të zhvillimit, me fokus të projektet publike në nivel qendror dhe vendor, të cilat kanë përparësi për zhvillimin ekonomik të vendit.

### **4. Zhvillimi i Infrastrukturës Fizike dhe Digjitale**

---

<sup>2</sup> Bruksel, 22.7.2015 COM (2015) 361 Komunikimi Përfundimtar nga Komisioni për Parlamentin Evropian dhe Këshillin: Bashkëpunimi për punësimin dhe rritjen: Roli i Bankave Kombëtare të Promovimit (NPBs) në mbështetje të Planit të Investimeve për Evropën.

Një nga objektivat e BZH-së do të jetë gjithashtu mbështetja e zhvillimit, përmirësimit dhe modernizimit të infrastrukturës fizike dhe digjitale, në përputhje me objektivat strategjike kombëtare, për të nxitur një ekonomi të qëndrueshme dhe të orientuar drejt teknologjisë.

## **II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE**

Ky projektligj nuk është pjesë e Programit të Përgjithshëm Analitik të Projekt akteve për vitin 2025.

## **III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

Themelimi i BZH ndjek modelet e një sërë vendesh evropiane në krijimin e një institucioni financiar promovues që synon të lehtësojë qasjen në financë për segmente dhe sektorë të nënfinancuar apo të nënshërbyer në ekonominë shqiptarë, si edhe të mbështesë projekte të rëndësishme zhvillimore duke kanalizuar, ndër të tjera, skema financimi apo garancie nga institucione financiare ndërkombëtare apo partnerë zhvillimi, me një fokus të veçantë në investime të gjelbra.

BZH synon të shërbejë si një mekanizëm financiar në mbështetje të zhvillimit të qëndrueshëm dhe konkurrues të vendit. Në thelbin e saj, BZH është krijuar për të mbështetur ndërmarrjet shqiptare që nuk kanë qasje të mjaftueshme në financim nga tregu tradicional. Kjo mbështetje është veçanërisht e rëndësishme për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, përfshirë mikrondërmarrjet dhe *startup*-et, të cilat shpesh përballen me vështirësi në sigurimin e kredive ose investimeve për zgjerim dhe inovacion. Përmes financimit, këto biznese kanë mundësinë të përmirësojnë produktivitetin e tyre dhe të konkurrojnë në tregjet ndërkombëtare.

Një tjetër rol i rëndësishëm i BZH është promovimi i eksporteve të mallrave dhe shërbimeve shqiptare. Duke nxitur tregtinë ndërkombëtare, institucioni kontribuon në zgjerimin ekonomik dhe krijimin e vendeve të reja të punës. Një fokus i veçantë i BZH është gjithashtu përmirësimi i infrastrukturës fizike dhe digjitale të vendit, duke kontribuar në një bazë më të fortë për zhvillim afatgjatë.

Përvojat ndërkombëtare kanë treguar se krijimi i institucioneve kombëtare të zhvillimit si BZH rrisin suksesin në nxitjen e zhvillimit ekonomik. Në vende të ndryshme, institucione të ngjashme kanë ndihmuar në transformimin e ideve dhe iniciativave investuese në projekte të realizueshme, duke kombinuar burimet publike dhe private për të përmirësuar infrastrukturën dhe konkurrencën.

Si një institucion financiar me një mandat zhvillimor, BZH adreson boshllëqet në financim për sektorët e nënfinancuar të ekonomisë, duke pasur rol plotësues ndaj financimeve të ofruara nga

institucionet tregtare, por edhe duke krijuar ura ndërmjet kapitalit publik dhe privat. Veprimtaria e saj synohet të kryhet në përputhje të plotë me rregullat për ndihmën e lejuar shtetërore.

Për të zbatuar në mënyrë efektive objektivat e saj, BZH do të krijojë një strukturë drejtuese, të ndërtuar mbi parimet e transparencës, llogaridhënies dhe efikasitetit. Një qasje e tillë jo vetëm që do të rrisë besimin e investitorëve dhe partnerëve, por gjithashtu do të sigurojë që projektet të jenë të qëndrueshme dhe të realizueshme. Për të arritur këto objektiva BZH parashikohet të angazhohet në një sërë funksionesh:

**Financimi dhe Investimi:** BZH jep kredi, ofron garanci dhe investon në letra me vlerë të borxhit dhe kapitalit, duke ndihmuar në realizimin e projekteve me rëndësi të veçantë për ekonominë.

**Nxitja e Projekteve Publike dhe Private:** Përmes skemave financiare, BZH mbështet projekte në nivele qendrore dhe vendore, duke u fokusuar në sektorët strategjikë.

**Promovimi i Eksporteve:** Institucioni luan një rol kyç në ndihmën e sipërmarrësve për të hyrë në tregjet ndërkombëtare dhe për të promovuar eksporte shqiptare në nivel global.

**Mbështetje për Sektorin Publik:** BZH synon të kontribuojë në përmirësimin e infrastrukturës që mbështet rritjen ekonomike dhe përmirësimin e shërbimeve publike. Duke bashkëpunuar me autoritetet publike, institucioni mund të veprojë si bashkë-financues ose bashkë-investues, duke ndihmuar në realizimin e projekteve të rëndësishme që përballen me sfida financiare, duke siguruar kështu përfitime të qëndrueshme për komunitetet dhe ekonominë.

**Menaxhimi i Burimeve dhe Kapitalit:** Për të mbështetur aktivitetet e saj, BZH pranon vendosje financiare nga bankat tregtare dhe institucione të tjera financiare, duke përdorur fondet e mbledhura për të financuar projekte dhe për të ndihmuar NVM-të.

**Roli i Ndërmjetësit Financiar:** BZH do të shërbejë si një platformë që kombinon kapitalin publik dhe privat për të financuar projekte me ndikim të gjerë. Përmes bashkëpunimeve me institucione financiare ndërkombëtare dhe vende partnere, ajo do të mbështesë zhvillimin ekonomik të vendit.

**Kontrolli dhe Transparenca:** BZH do të sigurojë menaxhim të përgjegjshëm dhe transparent përmes regjistrave dhe sistemeve të ndara financiare. Auditimet e brendshme dhe të pavarura do të kontribuojnë në rritjen e besueshmërisë dhe transparencës.

**Zhvillimi i Partneriteteve Strategjike:** Bashkëpunimi me institucione si Posta Shqiptare Sh.a., dhe entitete të tjera do të ndihmojë në mbledhjen e fondeve dhe në realizimin e projekteve. BZH gjithashtu ndërton marrëveshje me institucione ndërkombëtare për të avancuar qëllimet e saj strategjike.

Nëpërmjet një kombinimi të fuqishëm të vizionit strategjik dhe funksioneve operationale, BZH do të shërbejë si një katalizator për zhvillimin ekonomik të Shqipërisë. Me fokus në financimin e projekteve strategjike, përmirësimin e infrastrukturës, dhe promovimin e inovacionit, BZH synon të krijojë një ekonomi më të fortë, të qëndrueshme dhe konkurruese në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

#### IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Përgatitja e projektligjit është bazuar në nenet 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës së Shqipërisë dhe ligji nr. 9901/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar.

#### V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS* TË BASHKIMIT EVROPIAN (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Ky projektligj nuk synon përafrim me *acquis* të Bashkimit Evropian.

#### VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji është i ndarë në 4 kapituj dhe 26 nene.

Në **Nenin 1 – Qëllimi**, përcaktohet se ky ligj ka për qëllim krijimin e Bankës Shqiptare të Zhvillimit (BZH) dhe përcaktimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e saj. BZH synon të adresojë nevojat për një institucion të dedikuar për mbështetjen financiare dhe organizative të zhvillimit ekonomik dhe social të vendit.

Në **Nenin 2 – Objektivat e Bankës Shqiptare të Zhvillimit (BZH)**, përshkruhen objektivat kryesore të BZH-së, duke përfshirë financimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, promovimin e eksporteve, mbështetjen e projekteve publike strategjike dhe zhvillimin e infrastrukturës fizike dhe digjitale. Gjithashtu, ligji siguron ndarjen e qartë midis aktiviteteve promovuese dhe tregtare, duke respektuar legjislacionin për ndihmën shtetërore dhe rregullat e konkurrencës.

Në **Nenin 3 – Emri, Personaliteti Ligjor dhe Selia**, përcaktohet se BZH do të funksionojë si një shoqëri aksionare me emrin “Banka Shqiptare e Zhvillimit Sh.a.”, me seli të regjistruar në Tiranë. Institucioni do të ketë të drejtë të krijojë degë dhe shoqëri bija brenda dhe jashtë vendit.

Në **Nenin 4 – Objekti i Veprimtarisë**, përcaktohen aktivitetet kryesore që do të realizojë BZH, përfshirë dhënien e kredive, ofrimin e garancive, investimet financiare dhe zhvillimin e shërbimeve digjitale..

Në **Nenin 5 – Aksionarët**, përcaktohet se Shteti Shqiptar do të jetë aksionari kryesor dhe fillestar i BZH-së, me një pjesëmarrje minimale prej 51% të kapitalit. Gjithashtu, lejohet përfshirja e institucioneve financiare ndërkombëtare dhe entiteteve të tjera të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave.

Në **Nenin 6 – Kapitali Aksionar dhe llogarite e dedikuara**, përcaktohet se kapitali fillestar i BZH-së do të jetë 10 miliardë lekë, i kontribuar nga Shteti Shqiptar dhe i shlyer brenda një afati



katër (4) vjeçar, sipas rregullave të përcaktuara në Statut. Po ashtu, BZH do të ketë të drejtë të hapë llogari bankare në Bankën e Shqipërisë, në Thesarin e Shtetit, si dhe në banka tregtare vendase ose ndërkombëtare, si dhe të angazhohet në aktivitete ndihmëse për përmbushjen e objektivave të saj.

**Në Nenin 7 – Burimet Financiare**, theksohet se BZH mund të mbledhë fonde përmes mekanizmave të ndryshëm, duke përfshirë pranimin e fondeve të kthyeshme nga publiku dhe instrumente të tjera financiare, të garantuara nga Shteti Shqiptar. Një veçori e këtij neni është bashkëpunimi me Postën Shqiptare Sh.a. ose shoqëri të lidhura me të. Në këtë bashkëpunim, Posta Shqiptare ose entitetet e saj të lidhura do të luajnë rolin e ndërmjetësit midis BZH-së dhe publikut që dëshiron të përfitojë nga instrumentet financiare të lëshuara nga BZH, duke siguruar një qasje më të lehtë dhe efektive për qytetarët.

**Në Nenin 8 – Taksat**, përcaktohet se BZH do të jetë e përjashtuar nga tatimi mbi fitimin, duke i mundësuar fokusimin e burimeve në arritjen e objektivave të saj të zhvillimit.

**Në Nenin 9 – Përgjegjësia për Detyrimet**, përcaktohet se përgjegjësia për detyrimet e BZH-së do të rregullohet sipas legjislacionit për shoqëritë tregtare, përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe në këtë ligj.

**Në Nenin 10 – Organe të Vendimmarrjes dhe Drejtimit**, listohen organet kyçe të qeverisjes së BZH-së: Asambleja e Përgjithshme, Këshilli Mbikëqyrës, Këshilli i Administrimit dhe Komiteti i Auditimit, të cilat janë përgjegjëse për drejtimin strategjik dhe operacional të institucionit.

**Në Nenet 11-19, detajohen struktura organizative**, kompetencat dhe përgjegjësitë e organeve drejtuese, standardet etike dhe kriteret profesionale për anëtarët e tyre, si dhe kualifikimet e nevojshme për të garantuar funksionimin efikas të institucionit.

**Në Nenet 20-21 – Kontabiliteti dhe Auditimi i Pasqyrave Financiare**, përcaktohen standardet që rregullojnë mbajtjen e regjistrave financiare dhe procesin e auditimit, duke siguruar transparencën dhe përputhshmërinë me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare.

**Në Nenin 22 – Marrëdhënia me Kuadrin Ligjor**, përcaktohet se BZH do të ndjekë dispozitat e ligjit për shoqëritë tregtare, përveç rasteve kur ky ligj përcakton ndryshe. Gjithashtu, BZH nuk do të jetë subjekt i falimentimit ose likuidimit, përveçse me një ligj të veçantë.

**Në Nenin 23 – Marrëdhënia dhe Raportimi me Bankën e Shqipërisë**, përcaktohet se marrëdhëniet mes dy institucioneve do të rregullohen me një marrëveshje të veçantë, duke garantuar transparencë dhe bashkëpunim efektiv.

**Në Nenin 24 – Aktet Nënligjore**, theksohet se Këshilli i Ministrave do të miratojë aktet e nevojshme për zbatimin e këtij ligji brenda një periudhe 12-mujore.

**Në Nenet 25 dhe 26 – Dispozitat Kalimtare dhe Hyrja në Fuqi**, përcaktohen masat për bërjen operative të BZH-së dhe afatet për hyrjen në fuqi të ligjit.

## **VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT**

Për zbatimin e këtij projektligji ngarkohet Ministria përgjegjëse për financat dhe ajo përgjegjëse për ekonominë.

## **VIII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE SUBJEKTET E TJERA QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT**

Projektligji është hartuar nga Grupi Ndërinstitucional i Punës, i ngritur me Urdhrin e Kryeministrit nr. 168, datë 28.08.2024, “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për hartimin e projektligjit për krijimin e një institucioni me qëllim nxitjen e financimit dhe zhvillimit ekonomik” të ndryshuar, i kryesuar nga Ministri i Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesi dhe i përbërë edhe nga përfaqësues të Ministrisë së Financave, Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, Autoritetit Kombëtar për Sigurinë Kibernetike, Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndhmës, Departamentit të Administratës Publike dhe Postës Shqiptare, Sh.a. Në aspektin teknik, ky grup ka pasur mbështetjen e një strukture të përbërë nga ekspertë të pavarur me njohuri të thelluara në fusha si juridike, financiare, bankare dhe burimet njerëzore. Procesi i hartimit është realizuar gjithashtu nëpërmjet takimeve dhe diskutimeve me përfaqësues të institucioneve, si Banka e Shqipërisë, si dhe me mbështetjen e ekspertizës së ofruar nga Cassa Depositi e Prestiti.

## **IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE.**

Ky projektligj krijon efekte financiare pasi krijon strukturë të re shtetërore.

Efektet financiare do të bëhen të zbatueshme pas miratimit të kësteve të kapitalit, në përputhje me përcaktimet e statutit.

### **PROPOZUESI**

### **MINISTRI I SHTETIT PËR SIPËRMARRJEN DHE KLIMËN E BIZNESIT**

**Delina IBRAHIMAJ**